



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2037/5 Prot.

Vlorë më, 15.08.2025

VENDIM

Nr. 13, datë 15.08.2025

PËR

PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma e, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "*Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*" si dhe referuar shkresës së Administratorit të UV-së, me nr.2025/2, prot, datë 14.08.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 15.08.2025

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit pagesën e mbingarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë, për vitin akademik 2024-2025 sipas propozimeve të paraqitura nga njësitë bazë dhe njësitë kryesore, përveç rasteve të cituara më poshtë:
 - Orët e temave të diplomave pa dokumentacionin e plotë (të cilat do të merren në shqyrtim pasi të jetë dërguar në Rektorat dokumentacioni sipas procedurës së miratuar në vendimin e Senatit Akademik Nr.65, datë 14.11.2016 "*Për administrimin e dokumentacionit akademik dhe administrativ të Fakulteteve dhe Departamenteve*").
 - Orët suplementare mbi 200 orë në auditor për të cilat nuk ka dokumentacion argumentues nga përgjegjësit e njësive bazë (konform udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, i ndryshuar, "*për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*").
2. Mbingarkesa mësimore vjetore e pagueshme brenda dhe jashtë auditorit për secilin pedagog nuk do të kalojë mbi 300 orë mësimore në veprimtaritë akademike mësimore: leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, praktika.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Administrative për të llogaritur orët si dhe efektin financiar të mbingarkesës.
4. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr.Aurela Saliaj

